



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisionit të kultures, trashëgimisë kulturore, dhënies së titujve, emërtimeve.

RAPORT VENDIMMARRJE

Datë 28.08.2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për projekt propozimin për ndryshimin e emërtimeve të një segmenti të një rruge në lagjen Mllojë, Bashkia Vau Dejës, me emrin e propozuar “Zef Tanushi”, lagja Mllojë, Bashkia Vau Dejës.

Analiza ligjore: Mbështetur në ligjin 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar neni 20, neni (Neni 20: E drejta e iniciativës qytetare. 1.Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij,ose jo më pak se një përqind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë Brenda juridiksionit të njesisë së vetëqeverisjes vendore), neni 23, (Neni 23: Funksionet e bashkisë në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, pika 4. Ndërtimin rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimin rrugor, të trotuarëve dhe shesheve publike vendore.) neni 54 (Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, germall). vendos për emërtimin rrugëve, shesheve terrioreve, intitucioneve dhe objekteve në juridiksionin e bashkisë), ligji nr.9270,datë 29.07.2004 'Për sistemin e 3. adresave ndryshuar, Neni Emërtimi bulevardëve, rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve bëhet me vendim të këshillit të njësive të vetëqeverisjes vendore, nën juridiksionin e të cilave ato ndodhen. Neni 4/1 (shtuar me ligjin nr.9951, datë 10.07.2008) 1. Cdo njësi e qeverisjes vendore krijon,përditëson dhe administron të dhënat në regjistrin vendor të adresave. Shkresen e Ministrisë së Brendshme Nr.419 Prot date 11.02.2020, Shkresen e Ministrisë së Brendshme nr.3067 datë 07.12.2020,si dhe nisur nga kërkesat e Organiztës së Veteranëve, Bashkia Vau Dejës, që propozojnë ndryshimin/rregullimin e emërtimeve të një segmenti rruge në lagjen Mllojë.

Situata aktuale e funksionit: Pranë Bashkisë Vau Dejes, kanë paraqitur kërkesë Organizata e Veteranëve e Pasardhësve “LANC”, Bashkia Vau Dejës,ku kanë kërkuar ndryshimin/rregullimin e emërtimeve të një segmenti rruge në lagjen Mllojë dhe këtij segmenti propozojnë t'i vihet emri i dëshmorit të atdheut Zef Pjetër Tanushi. Gjithashtu pranë Bashkisë Vau Dejës është paraqitur banori Zef Tanushi i cili ka shprehur dëshirën për emëtimin e këtij segmenti rruge ,pasi ka trashëguar emrin e gjyshit të tij Zef Pjetër Tanushi Rruga është nje rrugice cila nuk ka dalje, me gjatësi 360 ml e cila rezulton e emertuar rruga Mllojë aktualisht dhe sipas kërkesës së Organizatës së Veteranëve e Pasardhësve "LANC", t'i vihet emri ZEF TANUSHI. Drejtoria e Planifikimit të Territorit ka drejtuar një shkresë zyrtare kundrejt Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit ku ka kërkuar informacion mbi verifikimin e pastërtisë për Zef Pjetër Tanushi në kuadër të propozimit për emërtimin e kësaj rruge,nga e cila na është informuar dhe sqaruar nga Autoriteti si më poshtë vijon: Mbi bzaën e dokumentacionit të disponueshëm nga ana jonë,si dhe nga verifikimet e kryera deri tani referuar të dhënave të paraqitura nga institucioni kërkues,për z.Zef Tanushi,nuk rezulton të ketë materiale në emër të tij,sipas Nenit 30,të ligjit nr.45/2015,'Për të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, i ndryshuar.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

IT'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Sanije Salja _____ **Kryetar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Ermir Tahiri _____ **Zv.Kryetar i komisionit**
(emri, mbiemri, firma)

Rregjinë Shelqetja _____ **Sekretar i Komisionit**
(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut.

Data 28.08.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 8 datë 11/08/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Korrik 2025"

Analiza ligjore:

Bazuar në ligjin nr. 139, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar; Ligjin nr. 57/2019, datë 18.7.2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; VKM-në nr. 597, datë 4.9.2019, "Për Përcaktimin e Procedurave të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndhmën Ekonomike", të ndryshuar, Si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 02, datë 27.01.2025, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2025"; Shkresën e Prefekturës së Qarkut Shkodër për shprehje ligjshmërie nr. 106/1 prot, datë 11.02.2025.

Situata aktuale e funksionit: --

Situata financiare : Projekt vendimi propozon që 1-Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin Korrik 2025 , familje 132, me 422.741 lekë, me 5.98% e fondit total. 2-Në total për Bashkinë Vau Dejës, për Muajin Kprrik 2025 janë shpallur fitues, 943 familje, me fond 7.046.392 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 422.783 lekë.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Sektori i Fuqizimit Ekonomik, Drejtoria e Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Turizmit, Rinisë dhe Sportit Sektori i Ndhmes Ekonomike dhe Pak kane relatuar për projekt vendimin.

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut dhe Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse.

Impakti social / grupet që preken: Ky projekt mbetet një mundësi e shkëlqyer për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të jetesës së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, si dhe në forcimin e rrjetit të mbështetjes sociale që është kaq i nevojshëm për komunitetin.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt i konsultimit publik

Komisioni i Mirëqenies Sociale, Rinisë, Barazisë gjinore, mosdiskriminimit, drejtave të njeriut, i mbledhur me datën 28/08/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.8 datë 11/08/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin "Projekt Vendim "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Korrik 2025" paraqitur nga sektori ndihmes ekonomike dhe PAK..

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Albina Livadhi _____ **Kryetar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

Meliha Zyberaj _____ **Zv.Kryetar i komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

Sanije Salja _____ **Sekretar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisoni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit

Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare.

RAPORT VENDIMMARRJE

Datë 28.08.2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 11 datë 25/07/2025 relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Ndryshimin e Vkb Nr 84 Datë 23.12.2024 "Miratimin e Buxhetit të Vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Perfundimtar 2025 -2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës".

Analiza ligjore: Këshilli Bashkiak Vau Dejës në mbledhjen e tij të datës 28.08.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika" 1.3, nenet 34-37, 40, 41, 54 shkronja "dh" të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; kreu III, nenet 10-20, kreu IV, nenet 22-30, kreu VI neni 2, kreu VII, nenet 39-41 të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore"; neni 44 i ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" të ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV"; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Ligjin 115/2024 "Per buxhetin e vitit 2025", Udhëzimin Plotësues nr 2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025, VKB-ne nr 84 datë 23.12.2024 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025-2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës", dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025 dhe relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës,

Situata aktuale e funksionit:

Duke u nisur nga shkresa Nr. 4120 Prot datë 24.07.2025 e Drejtorisë së Ndhmës Ekonomike, Arsimit, Rinisë, Sportit dhe Zhvillimit të Turizmit, Sektori i Arsimit, Rinisë dhe Sportit drejtuar Sektorit të Financës me lëndë "Kërkesë për Rishikim Buxheti viti 2025, viti 2026" zyra e financë buxhetit është angazhuar për të vënë në dispozicion vlerën e kërkuar për realizimin e projektit duke bërë rishpërndarje buxheti ndërmjet programeve buxhetore. Po ashtu në buxhetin e vitit 2025- 2026 do të bëhet shtesë e zërit me emërtimin "Rikonstrukcion fusha e futbollit Bushat" Kjo shkresë ka ardhur në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Vau-Dejës dhe FSHS-së, ku FSHF-ja është angazhuar të bashkëfinancoje 50% të vlerës së investimit total prej 36,259,842.14 ALL. Rishpërndarja e buxhetit do të bëhet sipas tabelës nr 1 dhe tabelës nr 2 përkatësisht për vitin 2025 dhe 2026 pjesë përbërëse e këtij projekt vendimi, për të mundësuar bashkëfinancimin nga ana e Bashkisë në vlerën 18,129,921.07 ALL Kemi prekur zëra buxheti të investimeve që nuk janë pjesë e projekteve prioritare për vitin 2025, gjithashtu është bërë shtesë projekti për zërin "Rikonstrukcion fusha e futbollit Bushat" në zbatim të nenit 100 Rishpërndarja e fondeve buxhetore të njesise së veteqeverisjes vendore, ligji nr. 68/2017 "Për financat e veteqeverisjes vendore", udhëzimit Plotësues Nr. 2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit 2025"; Vendimit të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Nr. 84 datë 23.12.2024 "Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025-2027, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës" miratuar me shprehje ligjshmerie



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

nga Prefektura Shkodër me shkresë nr. 860/1 prot datë 06.01.2025. Me këtë projekt vendim zërat që pakësohen janë zëra ku ka mjaftueshmeri fondesh.

A është objekt i konsultimit publik: Po është objekt i konsultimit publik dhe konsultimi është realizuar me datë 21.08.2025 dhe të pranishmit kanë shprehur dakortësi për projekt vendimin e paraqitur.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Ekonomike dhe e Menaxhimit Financiar ka relatuar përpara komisionit

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë Ekonomike dhe të Menaxhimit Financiar ose Drejtorinë përgjegjëse për zbatimin e projekteve të caktuara.

Impakti social / grupet që preken: Programi Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 dhe Buxheti Vjetor për vitin 2025 impakton jetën të gjitha shtresave, kategorive dhe zhvillimin e të gjithë territorit të Bashkisë Vau i Dejës

Komisioni i Përhershëm për "Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik dhe Mbikqyrjes Financiare", i mbledhur me datën 28/08/2025, shqyrtoi projekt vendimit nr.11 datë 25/07/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Ndryshimin e Vkb Nr 84 Datë 23.12.2024 "Miratimin e Buxhetit të Vitit 2025 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Perfundimtar 2025 -2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës"., paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Neki Kapllani _____ **Kryetar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

Arsen Mehmeti _____ **Zv.Kryetar i komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

Florin Tanushi _____ **Sekretar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK VAU I DEJËS

Komisioni Bujqesise, pyjeve, menaxhimit te ujërave , mbrojtjes mjedisit dhe biodiversitetit.

RAPORT VENDIMMARRJE

Datë 28.08.2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda:

-Vendim për projekt vendimin për dhënien në përdorim me afat deri në 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 3 ha “Për aerogjenerator (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 4.063 km rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim në ekonominë pyjore Gjader Mnelë”

-Vendim për projekt vendimin për dhënien në përdorim me afat deri në 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 5.3 ha “Për aerogjenerator (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 5.258 km rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim në ekonominë pyjore Gjader Mnelë”

-Vendim për projekt vendimin për dhënien në përdorim me afat deri në 10 vjeçar sipërfaqen pyjore prej 5 ha “Për aerogjenerator (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 3.909 km rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim, 6.709 km linja transmetimi të energjisë elektrike në ekonominë pyjore Gjader Mnelë”

Analiza ligjore: Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar në nenin 9 pika 1.2, nenin 27 pika 5, nenin 54 shkronja "el", neni 18 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr 57/2020 "për pyjet" ligjin nr 9693 date 19.03.2007 per fondin kullisor i ndryshuar pika 49 e VKM nr. 433 datë 08.06.2016, i ndryshuar Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive" pika nr 2 germa (a) dhe pika 7 të Udhëzimit nr. 1. datë 09.06.2016 të Ministrit të Mjedisit "Për Rregullat e procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullisor publik" VKM nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore"Shtojca 1 pikat 8;per aerogjeneratorë dhe pika 11; për rrugë kalimi, VKM nr 467 datë 31.07.2025 per miratimin e tarifave ne fondin kullisor.

Situata aktuale e funksionit:

Administrimi i Aseteve publike në territorin e Bashkisë është një ndër funksionet e Bashkisë.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 9 pika 1.2 c, neni 54 pika e/l, neni 18, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë miratimi i dhënies në përdorim të tretëve sipas legjislacionit në fuqi, të pasurive shtetërore në pronësi apo administrim të Bashkisë.

-Sipërfaqja që do të jepet në përdorim është 3 ha "për aerogjeneratorë(stacionet,objektet përkatëse etj) dhe 4.063 km rrugë për tu lidhur me sipërfaqen qe do jepet në përdorim, Në funksion të sipërfaqes që merret në përdorim, sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore" VKM nr 467 datë 31.07.2025 shtojca 3.

-Sipërfaqja që do të jepet në përdorim është 5.3 ha "për aerogjeneratorë (stacionet,objektet përkatëse etj) dhe 5.258 km rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim,Në funksion të sipërfaqes që merret në përdorim, sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore"

-Siperfaqja që do të jepet në përdorim është 5 ha "për aerogjeneratorë (stacionet, objektet përkatëse etj) dhe 3.909 km rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do të jepet në përdorim (qira), si dhe 6.709 km linje transmetimi të energjisë elektrike. Në funksion të sipërfaqes që merret në përdorim, sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore"

Për projekt vendimet e paraqitura është realizuar konsultim publik me banorët e fshatit Mnel e Madhe, të cilët kanë shprehur dakortësi për miratimin e projekt vendimeve.

Situata financiare :

Tëardhurat vjetore që përfiton Bashkia nga miratimi i projekt vendimeve është:

-Për projekt vendimin nr.6, të ardhurat vjetore janë : 581,260 (Pesëqind tetëdhjetë e një mijë e dyqind e gjashtë dhjetë) lekë në vit.

-Për projekt vendimin nr.7, të ardhurat vjetore janë : 1,124,199 (Njëmilion e njëqind e njetë e kater mijë e njëqind e nëntë dhjetë e nëntë) lekë në vit.

-Për projekt vendimin nr.7, të ardhurat vjetore janë : 979,085 (Nëntëqind e shtatëdhjetë enente mijë e tre qind e tetë dhjetë e pesë) lekë në vit.

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e pyjeve, turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit-sektori menaxhimit të pyjeve dhe kullotave

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni Bujqesise, pyjeve, menaxhimit të ujërave , mbrojtjes mjedisit dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e vendimeve do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e pyjeve, turizmit dhe mbrojtjes së mjedisit-sektori menaxhimit të pyjeve dhe kullotave për zbatimin e projekteve të caktuara.

Impakti social / grupet që preken: Rrit nivelin e të ardhurave të Bashkisë si dhe krijon mundësinë për punësim të banorëve të Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,
Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Kastriot Shkja _____ **Kryetar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

Mirela Vasija _____ **Zv.Kryetar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

Aleko Dodani _____ **Sekretar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)